



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

**PLANI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
MENAXHIMIN E MBETURINA
(PRKMM)**

2013 – 2017

Prishtinë
2013

Hartues i Planit të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave është:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

VIZIONI: 2013 - 2022

Reduktimi



Ripërdorimi



Riciklimi



Prodhimi i energjisë



Deponimi

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
KAPITULLI I	5
1. HYRJE	5
2. ORGANIZIMI I PRKMM (2013 - 2017)	5
2.1. BAZA LIGJORE	5
2.2. PROCESI I PRKMM	6
2.3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PRKMM.....	7
2.4. RENDITJA DHE PESHA E PRIORITETEVE	7
3. ZBATIMI I PVMM (2013 - 2017)	9
3.1. PLANI PËR ZBATIM	9
3.2. VEPRIMET KRYESORE DHE AGJENSITË UDHËHEQËSE PËR PRKMM (2013 - 2017)	10
3.3. AFATI PËR PRKMM (2013 - 2017).....	10
4. FINANCIMI I PRKMM (2013 - 2017)	11
KAPITULLI II	12
1. PËRMBLEDHJA	12
2. PËRMBLEDHJE E INVESTIMEVE	13
3. PROJEKTET ME PRIORITET TË LARTË	14
3.1. INVESTIMET ME KOSTO TË LARTË (>€3 MILION)	14
3.2. INVESTIMET ME KOSTO TË MESME (€1-3 MILLION)	15
3.3. INVESTIMET ME KOSTO TË ULËT (<€1 MILION).....	16

SHKURTESAT

AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
AKMM	Agjensia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
BK	Buxheti i Kosovës
DDM	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit në MMPH
E/P	Ekuivalenti i Popullsisë
EHCIP	(Akronim standard) Environmental Heavy Cost Investment Planning
KB	Kombet e Bashkuara
KKPIM	Kostoja e Kushtueshme e Projektit të Investimeve për Mjedisin
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
€	Monedha Euro
MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MTI	Ministria e Tregtis dhe Industrisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
mln	milion (10 ⁶)
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
PPP	Partneriteti Publiko Privat
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
PRKMM	Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
PKVM	Plani Kombëtar i Veprimit Mjedisor (2012 - 2016)
SRKMM	Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
SKM	Strategjia e Kosovës për Mjedis
UP	Universiteti i Prishtinës
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
ZSK	Zyra e Statistikave të Kosovës
KE	Komisionit Evropian

KAPITULLI I

Për përgatitjen e Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin (2013-2017), së pari u krijuan objektivat strategjike dhe prioritetet e përgjithshme. Këto janë hartuar edhe në Draft Strategjinë e Kosovës për Mjedisin (2012 - 2020) si dhe në Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturineve 2013-2022.

Plani u punua në një proces pjesëmarrës që përfshin grupet e Punës të MMPH dhe institucioneve tjera pjesëmarrëse në hartimin e strategjisë. Bazuar në rezultate, u zhvilluan një numër i veprimeve afatmesme për PRKMM. Ky plan paraqet disa kriteret të përdorura për formulimin e tij.

Objektivat kryesore në këtë plan janë:

- i. forcimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave,
- ii. Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturë,
- iii. ngritja e shkallës së vetëdijes dhe ndërgjegjësimit, si dhe informacionit.

Gjithashtu janë përshkruar mekanizmat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit, përditësimit dhe rishikimit dhe me përcaktim për burimet e mundshme të financimit.

1. HYRJE

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturineve (SRKMM) ka mundësuar që të nxjerret Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturineve (më tej, PRKMM). Këto dy dokumente do të jenë udhërrëfyes për të gjitha investimet që lidhen me fushën e mbeturinave. Zhvillimi i konceptit strategjik për menaxhimin e mbeturinave do të arrihet hap pas hapi sipas vizionit të SRKMM 2013 deri në 2022.

Vitet e synuara për zhvillimin e PRKMM janë 2013 deri në 2017. Kjo periudhë kohore sipas strategjisë, e fokusuar si Faza e parë 2013-2017- Ndërtimi dhe stabilizimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave.

Në këtë mënyrë, kjo PRKMM (2013 - 2017) duhet të shihet si një dokument për zhvillim të puneve. Pas miratimit të PRKMM nga Qeveria e Kosovës, ky plan, praktikisht do të paraqesë një program operativ për zbatimin e SRKMM.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), sipas Ligjit për mbeturina është përgjegjëse për hartimin e SRKMM dhe PRKMM. Të dy dokumentet janë rezultat i bashkëpunimit mes MMPH dhe ministrive të tjera, disa organizatave mjedisore, OJQ-ve, akademisë, instituteve kërkimore, profesionistëve, ekspertëve dhe individëve të interesuar. Në këtë mënyrë, kanë qenë të mbuluara tërësisht sektorë të ndryshëm të mjedisit me ç'rast është paraqitur një gamë e gjerë e zgjidhjeve të mundshme.

Një mirënjohje e madhe për të gjithë ata që janë përfshirë në procesin e hartimit të PRKMM.

2. ORGANIZIMI I PRKMM (2013 - 2017)

2.1. Baza ligjore

Baza ligjore për hartimin e PRKMM buron nga neni 10 i Ligjit për Mbeturina (Ligji nr. 04/L060). Sipas këtij ligji PRKMM me propozim të MMPH, miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës për një periudhë (5)-pesë vjeçare. PRKMM, duhet të përfshijë masat për menaxhimin e mbeturinave komunale, mbeturinave të rrezikshme në përgjithësi dhe në veqanti duhet të përfshijë edhe mbeturinat e veqanta të specifikuar në nenin 38 të Ligjit për mbeturina,

2.2. Procesi i PRKMM

PRKMM (2013 - 2017) është përgatitur duke u bazuar në SRKMM e cila është hartuar në takime dhe punëtori me pjesëmarrje të palëve të interesuara dhe ekspertëve.

Në këtë proces janë përfshirë 5 - grupe Grupet Punuese- Grupi Ligjor, GP për shërbimet komunale publike me mbeturina, GP Mbeturinat Industriale, GP Mbeturina te rrezikshme, GP Struktura e administrimit te mbeturinave- ekonomia, tregu i punës dhe me mbi 50 - ekspertë dhe përfaqësues institucioneve, të bizneseve, KE, OQ dhe OJQ etj.

2.3. Qëllimet, fushëveprimi dhe objektivat e PRKMM

Qëllimi i përgjithshëm i PRKMM (2013 - 2017) është përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në Republikën e Kosovës. Ky plan do të çojë në:

- një cilësi më të mirë të jetës për të gjithë qytetarët;
- zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe kulturor.

PRKMM -ja (2013 - 2017) është e organizuar më tej në tre (3) objektiva kryesore që janë paralele me këto parime dmth:

- (i) një program dhe mbështetja e veprimeve për të forcuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave,
- (ii) një program i investimeve në pjesët me probleme kritike për mbeturina;
- (iii) veprime për përmirësimin e informimit dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

Një përmbledhje e përgjithshme e qëllimit PRKMM është, reduktimi i sasisë, dhe rreziqeve nga mbeturinat, ripërdorimi, trajtimi dhe ulja e nivelit të ndotjes sipas kërkesave të legjislacionit vendorë atij të BE-së dhe standardet tjera ndërkombëtare.

Objektivi kryesor i PRKMM është ndërmarrja e sërë masash në Republikën e Kosovës me të cilat do të duhej të zvogëloj sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen dhe ngritjen e sistemit të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave.

Në PRKMM përcaktohen projektet në fushën e menaxhimit të mbeturinave për periudhën pesëvjeçare (2013-2017), në harmoni me SRKMM dhe mundësit ekonomike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Ngritjen e infrastrukturës për ndërtimin e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (Zvogëlim – Ripërdorim - Riciklim- Djegie - Deponim) pra për të krijuar kushtet për funksionim më efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave
- Përmirësimi i shërbimit për mbeledhjen e mbeturinave komunale (përmirësimi isistemit aktual, zgjerimi i zonave të grumbullimit, ekzamenimi dhe harmonizimi i kapaciteteve për depnimin e mbeturinave).

- Edukimi i publikut, ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit
- Hartimi i legjislacionit dhe udhëzuesve për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimi i saktë dhe inventarizimi i mbeturinave të rrezikshme;
- Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme të trashëguara,
- Ngritja e përgjegjësisë së prodhuesit të produkteve dhe mbeturinat nga produktet.

2.4. Renditja dhe pesha e prioriteteve

Duke shfrytëzuar kriteret si në tab. 1. janë identifikuar projektet që disa prej tyre kanë kosto të lartë dhe ca të tjerët me kosto më të vogël.

Tabela 1: Kriteret që përdoret për prioritizimin e projekteve

Kriteret dhe Pesha	Shpjegimi
Shëndeti njerëzor (Rëndësia relative = 0.3)	Përmirësime në kushtet e mjedisit të njerëzve dhe komuniteteve; ndikimi i përmirësimeve të tilla në zhvillimin njerëzor në aspektin cilësor dhe sasior
Ndikimi ekologjik (Rëndësia relative = 0.3)	Përmirësime në kushtet mjedisore për florën dhe faunën, ndikimi në ciklin ekologjik për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e procesit natyror
Vlerat kulturore dhe historike (Pesha relative = 0.2)	Ndikimi i përmirësimeve në kushtet e mjedisit në identifikimin, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike
Produktiviteti Ekonomik (Rëndësia relative = 0.2)	Efeki i përmirësimeve në kushtet mjedisore në shfrytëzimin e burimeve; ndikimi i përmirësimeve të tilla në nivelin e zhvillimit ekonomik

Nga aspekti kohor i realizueshmërisë, janë zgjedhur dy metoda. Për projektet afat-shkurtra dhe te mesëm janë përdorur kriteret e mëposhtme: tab 2.

Tabela 2: Sistemi i renditjes që përdoret për prioritizimin e projekteve

Titulli i Projektit
Kostoja ⁽¹⁾
Përfitimet ⁽²⁾
Ndikimi në shëndetin Njerëzor ⁽³⁾
Kërkohet me ligjin e Kosovës ⁽⁴⁾
Pjesë e procesit të harmonizimit të BE-së ⁽⁵⁾
Ndikimi ndërkufitar ⁽⁶⁾
Gjithsejtë
<i>Vërejtje:</i>
(1) E përballuar nga Qeveria e Kosovës: 5 = deri në €100 000, 4 = deri në €500 000, 3 = deri në €1 milion, 2 = deri në € 5 milion, 1 = >€ 5 milion Kontributet nga donatorët 1 = deri në €100 000, 2 = deri në €500 000, 3 = deri në €1 milion, 4 = deri në € 5 milion, 5 = >€ 5 milion
(2) 3 = maksimum, 2 = i mesëm, 1 = mesatare
(3) 3 = maksimum, 2 = i mesëm, 3 = mesatare
(4) 3 = siç specifikohet me ligj, 1 = nuk specifikohet me ligj
(5) 3 =fondet e akorduara nga qeveria, 1 = për momentin nuk ka fonde të akorduara
(6) 3 = ndikime të konsiderueshme ndërkufitare, 2 = ndikime mesatare, 1 = ndikimi i vogël

Formulimi i PRKMM (2013 - 2017) më pas është përcaktuar duke i kombinuar objektivat e zbatimit me peshën dhe renditjen e prioriteteve. Rënditje është udhëhequr edhe nga parimet e demokracisë dhe pjesëmarrjes së palve të interesuara, konsensusit dhe

përkushtimit, efikasitetit dhe racionalitetit ekonomik, koordinimi dhe përvetësimi i prioritetëve dhe de-centralizimi i kompetencave në nivelin lokal.

Për investimet afat-mesme, është përdorur një sistem që merr parasysh kapacitetet e financimit nga burime të ndryshme, sidomos nga donatorët.

Megjithatë, duhet të vihet re se disa nga projektet janë të rëndësishme, prandaj do të duhet realizuar më me përparsi.

3. ZBATIMI I PRKMM (2013-2017)

3.1. Plani për zbatim

Plani i propozuar për zbatim përfshin tri faza:

- (i) hapat fillestar,
- (ii) monitorimin dhe vlerësimin,
- (iii) përditësimin dhe rishikimin.

Hapat fillestare përfshijnë:

- i. miratimin zyrtar të PKVM-së nga ana e Qeverisë,
- ii. integrimin e PRKMM në planet vjetore të përgatitura nga DMM- MMPH,
- iii. shtrimin e veprimeve të PRKMM në programet e agjencive dhe të organizatave të tjera.

Ato do të raportojnë nëse objektivat dhe përparësitë e PRKMM janë duke u arritur në bazë të matjeve në vijim:

- Parandalimi dhe Ulja e ndotjes;
- Përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave dhe të shërbimeve për to;
- Përdorimi i racional i burimeve nga palët e interesuara;
- Promovimi i praktikave të qëndrueshme mjedisore p.sh. politikave, programeve dhe projekteve që mbështesin menaxhimin e mbeturinave.
- Reduktimi dhe minimizimi i rreziqeve mjedisore nga mbeturinat (të shkaktuara nga industria).

Këta tregues duhet të mblidhen dhe analizohen rregullisht, nëse duan të jenë mjete efektive për monitorimin e zbatimit të PRKMM (2013 - 2017).

Burime të tjera të rëndësishme të monitorimit të informacionit do të përfshijnë:

- përcjellja nga fillimi deri në fund të projektit, (për të gjitha projektet) dhe investimit lidhur me PRKMM;
- rishikime periodike dhe të rregullta të performancës së PRKMM (p.sh. çdo vit) për të vlerësuar rëndësinë dhe efektivitetin e zhvillimit të projektit.

Për të rritur shpërndarjen e informacionit dhe ndërgjegjësimin e publikut, duhet të bëhet publikimi i rregullt dhe shpërndarja e treguesve të PRKMM. Gjithashtu, raporti "Gjendja e Mjedisit" i përgatitur nga AKMM duhet të përfshijë këto analiza. Për më tepër, në faqen e internetit të MMPH duhet të raportohen rezultatet për qasje të të gjithë qytetarëve.

Në të vërtetë, monitorimi i shpërndarjes së informatave është pjesë e reagimet publik dhe një burim i dobishëm për të përmirësuar performancën e zbatimit të PRKMM. Pastaj duhet të bëhet vlerësimi i rregullt dhe formal nga MMPH. Përveç kësaj, aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave kërkojnë pjesëmarrje të gjerë, konsensus dhe mekanizma demokratike.

Pjesëmarrja e palëve të interesuara dhe publikut në *përditësimin dhe rishikimin* e PRKMM është e përfshirë në Ligjin për mbeturina dhe Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

3.2. Veprimet kryesore dhe agjencitë udhëheqëse për PRKMM (2013 - 2017)

Veprimet kryesore të nevojshme për zbatimin e PRKMM dhe agjencitë udhëheqëse të përfshira janë përmbledhur më poshtë në tabelën 3. Ato përbëjnë thelbin e planit të veprimit, së bashku me programin e veprimit për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Çdo investim (fushëveprimi, agjenci përgjegjëse, kornizë kohore, vlerësim i koston dhe sugjerimi i burimit i financimit) është i detajuar në Kapitullin II.

Pasqyra e projekteve për investime dhe të agjencive udhëheqëse për zbatim

Projektet e Investimeve	Agjencia udhëheqëse
Objektiva 1: Forcimi i Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave	
Harmonizimi i legjislacionit vendorë me legjislacionin e BE-së	MMPH
Planifikimi i menaxhimit të mbeturinave	MMPH, Komunat, MBPZHR, MAPL
Dizajnimi dhe zbatimi i instrumentave ekonomike të përshtatshme për vjelljen dhe taksave dhe investimet në fushën e menaxhimit të mbeturinave.	MMPH, MeF
Mbështetja për hartimin e Planit lokal për komunave	MMPH, MAPL, Komunat
Licencimi i operatorve për trajtimin e mbeturinave	MMPH, Inspektorati
Zbatimi i legjislacionit vendorë dhe të UE për Mbeturina	MMPH , Komunat,
Zhvillimi i instrumenteve ekonomike	MMPH, MeF
Objektiva 2: Investimi në Zonat me Probleme Kritike dhe Infrastruktura	
Mjedisi urban – pastrimi rregullime i vendeve të ndotura	MMPH, Komunat, PPP
Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta (EHCIP-s)	MMPH, Komunat, PPP
Inkurajimi i përdorimit të mbeturinave për përfitimin e energjisë	MMPH, MAPL
Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme	MMPH, Komunat, PPP Kompanitë prodhuese,
Përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave	MMPH, Komunat, PPP
Zvogëlimi i rrezikut nga mbeturinat	MMPH,
Objektiva 3: Rritja e Informimit dhe Ndërgjegjësimin	
Mbledhja e të dhënave për mbeturina	MMPH, Zyra e Statistikave AMMK
Edukimi dhe trajnimi për menaxhimin e mbeturinave	MMPH, MASHT

3.3. Afati për PRKMM (2013 - 2017)

PRKMM është menduar të zbatohet për një periudhë 5 vjeçare 2013 - 2017. Për këtë arsye janë të përzgjedhur vetëm termat projekte afatshkurtëra (dmth 1-2 vjet) dhe afatmesme (3-5 vjet). Kjo i referohet kohës së fillimit dhe jo periudhës së përgjithshme për përfundimin e projektit. Gjatë gjysmës së dytë të periudhës së PKVM do të identifikohen masa të tjera bazuar edhe mbi rezultatet e monitorimit dhe fazën e vlerësimit.

4. FINANCIMI I PRKMM (2013 - 2017)

Plani i financimit për PRKMM do të varet nga burimet si vijon:

- **Burimet qeveritare** - të ardhurat nga pushteti qendror, burimet e qeverisjes Komunale, pagesat për shërbimet publike, tarifa të tjera për mjedisin dhe taksat mjedisore; Mbështetja e sektorit privat - p.sh. financimi nga industria për shpenzimet e tyre të ndotjes, dhe partneritetit publiko-privat për të financuar infrastrukturën e mjedisit dhe të shërbimeve;
- **Financimi ndërkombëtar** - huamarrja e valutës së huaj nga bankat jashtë shtetit, kreditë dhe grantet nga donatorët bilateralë dhe OJQ-ve ndërkombëtare dhe granteve, si dhe huave nga agjencitë për zhvillim ndërkombëtar.

Pa marrë parasysh se sa e vështirë do të jetë vendim-marrja, nuk ka largim nga fakti se zonat me probleme kritike për mjedisin do të marrin investime shumë-milionëshe në Euro. Fonde të tilla janë të kufizuar për çdo vend në tranzicion siç është Republika e Kosovës. Edhe pse kjo në shikim të parë mund të duket e frikshme për burimet e financimit, duhet të mbahet mend se këto janë investime kritike dhe duhet të bëhet në një fazë, në qoftë se Kosova do të përmbushë Rregulloret e BE-së dhe standardet ndërkombëtare mjedisore.

Për më tepër, vlerësimi i shpenzimeve bëhet që të sigurojë një tregues të rendit të madhësisë së investimeve mjedisore të nevojshme në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Ajo nuk ka marrë parasysh kriteret për "gatishmërinë për të paguar" as "aftësinë për të paguar". Përveç kësaj, çështje kyçe është norma e kthimit mbi investimin.

Me menaxhimin e duhur (nga MMPH), mekanizmat efikasë për rikuperimin e kostos në vend (parimi ndotësi paguan) të gjithë qytetarët dhe industrinë duhet të kontribuojnë për shpenzimet për shërbimet e ofruara të mjedisit. Kjo gjithashtu do të mbështetet nga instrumente të tjera ekonomike dhe krijimi i Eko-Fondit shihet kështu si një nga veprimet me prioritet për PRKMM (2013 - 2017). Kjo do të jetë kritike për financim të qëndrueshëm në të ardhmen dhe mund të jetë një "goditje fillestare" për tërheqjen e investimeve të reja në teknologji më të pastra dhe më moderne.

KAPITULLI II

Ky kapitull jep detaje të projekteve me prioritet të përcaktuara nga DMM- MMPH për PRKMM (2013- 2017). Çdo investim është treguar me sektorin, fushëveprimin, agjencionin udhëheqëse përgjegjëse për zbatimin, një tregues i afatit dhe një vlerësim i kostove. Pastaj ka një kolonë me burime të sugjeruara për financim ose nga donatorët ose nga Buxheti i Kosovës (BK) apo një përzierje e të dyjave. Pjesëmarrja e sektorit privat do të jetë gjithashtu i rëndësishëm, por kontributi i tyre do të përcaktohet ngar raportet e krijuara me MMPH, derisa projektet zhvillohen me tej.

1. PËRMBLEDHJA

Investimet për menaxhimin e mbeturinave mund të ndahen në dy pjesë:

1. Me prioritet të lartë: që do të zbatohen në afat të shkurtër (1-2 vjet);

- I. kosto të lartë (>3 milion €) me pjesën më të madhe të financuar nga donatorët;
- II. kosto mesatare (mes 1 – 3 milion €) me burime të përziera financimi(Buxhet Kosovës dhe donatorët);
- III. kosto të ulët (<1 milion €) me pjesën më të madhe të financimit nga Buxheti Kosovës

2. Prioritet mesatar: që do të zbatohen në afat të mesëm (3 – 5 vjet)

- I. kosto të lartë (>3 milion €) me pjesën më të madhe të financuar nga donatorët;
- II. kosto mesatare (mes 1 – 3 milion €) me burime të përziera financimi(Buxhet Kosovës dhe donatorët);
- III. kosto të ulët (<1 milion €) me pjesën më të madhe të financimit nga Buxheti Kosovës

Çdo investim është paraqitur me qëllimin, agjencinë përgjegjëse për zbatim, periudha kohore, vlerësimi i koston dhe burimin e sugjeruar të financimit. Rezultatet janë paraqitur në kapitullin 3 dhe 4 në vijim.

2. PËRMBLEDHJE E INVESTIMEVE

Tabela 4: Përmbledhja e investimeve për menaxhimin e mbeturinave dhe kontributet nga burime të sugjeruara

Investimet	Totali i Projektev.	Kosto totale (€)	Burimet e sugjeruara të financimit		
			Donor	BK	Komuna
			[€]	[€]	[€]
Prioritet për (1-2 vjet)					
Kosto të larta (>3 mln €)	1	3.5 mln	1.05 mln	2.45 mln	-
Kosto mesatare (€1 – 3 mln)	3	4.05 mln	1.935 mln	2.115 mln	-
Kosto të ulëta (<€1 mln)	10	3.355 mln	1.12mln	1.985mln	0.250 mln
Sub-Total	14	10.905 mln	4.105	6.55	0.250 mln
Overall contribution			37.64%	60.06%	2,3%
Prioritet i mesëm (3-5 vjet)					
Kosto të larta (>€3 mln)	5	23.5 mln	9.35 + 3.25 JICA	4.55mln	6.35mln
Kosto mesatare (€1 – 3 mln)	4	6.4 mln	1.1 mln	4.1mln	1.2 mln
Kosto të ulëta (<€1 mln)	10	4.32mln	2.13mln	2.19mln	-
Nën-Totali	19	34.22mln	15.83mln	10.84mln	7.55 mln
Kontributi i përgjithshëm			46.25 %	31.25%	22.1%
	GJITHSEJ	45.125 mln	19.935 mln	17.39mln	7.8 mln

Duke marrë shënimet nga Zyra e statistikave të Kosovës e vitit 2011, me 1.733.870 mil banor, zbatimi i plotë i PRKMM (2013 - 2017) për një mjedis të pastër dhe të sigurtë, si bazë për zhvillimin e vërtetë ekonomik të Kosovës do të thotë përafërsisht € 26.03 euro/banor për një periudhë 5 vjeçare.

3. REALIZIMI I PROJEKTEVE SIPAS KËTIJ PLANI

3.1. Investimet me kosto të lartë (>€3 milion)

Objektivi 1: Forcimi i sistemit për Menaxhimin e mbeturinave					
Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturë					
Objektivi 3: Rritja e shkallës së vetëdijsimit, ndërgjegjësimit dhe Informimit					
Masat	Qëllimi i investimeve -Veprimet	Agjencia udhëheqëse	Periudha kohore	Kostoja vlerësuar [€]	Burimet sugjeruara
MBETURINAT					
1.Trajtimi - Infrastrukturë	Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave.-6-qendrave për trajtimin e mbeturinave nga konstruktim - demolimit i objekteve ndërtimore Prishtinë, Gjakove, Ferizaj, Prizren, Mitrovicë, Pejë,	Qeveria MMPH Komunat	2014-2017	€ 4.5 mln	40%,donatorët 30%. BK 30% komunal
2.Deponim infrastrukturë	Ndërtimi i deponisë regjionale të mbeturinave komunale në Pejë.	Qeveria MMPH Komunat	2014-2015	€ 3.5 mln	30% donator 70% BK
3. Trajtimi dhe Infrastrukturë	Nritja e impijantit për trajtimin e mbeturinave nga therrja e kafshëve dhe përpunimi i mishrave	Qeveria AVUK MMPH	2013-2017	€ 3,5 mln	80% donatorët 20% BK
4. Menaxhimi Infrastrukturë	Përmirësimi i menaxhimit të deponive të mbeturinave komunale dhe trajtimi i ujrave të ndotura të deponi-Landovicë, Gjilan, Podujevë, Prishtinë.	MZHE MMPH KMDK	2014-2017	€ 4,0 mln	70% donatorët 30% BK
5. Mbledhje-Infrastrukturë	Blerja e pajisjes dhe Makinave për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale, Prizren, Prishtinë	Qeveria MPL Komunat	2013- 2017	€ 6.5mln	50% JICA 30%Donatorët 20% MMPH
6. Menaxhim	Pastrimi i vendeve me mbeturina nga hudhja ilegale në komunat e Kosovës	Qeveria MPL Komunat	2013-2017	€ 5.0 mln	Komuna
Kostoja totale				€ 27.0 mln	

3.2. Investimet me kosto të mesme (€1-3 milion)

Objektivi 1: Forcimi i sistemit për Menaxhimin e mbeturinave Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturë Objektivi 3: Rritja e e shkallës së vetëdijsimit, ndërgjegjësimit dhe Informimit					
Masat	Qëllimi i investimit - Veprimet	Agjencia udhëheqëse	Periudha kohore	Kostoja e vlerësuar	Burimet e sugjeruara
MBETURINAT					
1.Mbledhje- infrastrukturë	Ngritja e 4 -transfer stacioneve dhe qendrave për pranimin dhe klasifikimin e mbeturinave në lloje Klinë, Burim, Skenderaj, Novobërd.	Komuna MMPH	2014-2017	€2.0 m	50%BK 30%donator 20% komuna
2. Masat e përgjithsme- Menaxhim	Hartimi i Planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave nga komunat;	MMPH	2013 - 2014	€1.05 m	70% donator 30 % BK
3. Mbledhje Infrastrukturë	Blerja e kontejnerve të ndryshëm për mbeturinat komunale,	MMPH komunat	2014-2017	€2.0 m	60%BK 40%komuna
4. Deponim Infrastrukturë	Përmirësimi i gjendjes teknike në deponine e regjionit te Prishtinës – Obiliq	MZHE KMDK	2014-2015	€1.5 m	BK
5. Redukim i mbeturinave	Pastrimi i lumit Lepec ga mbeturinat e azbestit – Hani i Elezit	MMPH Komuna e hanit elezit	2013-2015	€1.4 m	BK
6. Magazinim Infrastrukturë	Ndërtimi i objekteve për ruajtjeve e përkohëshme të mbeturinave të rrezikshme dhe mallrave të rrezikshme të konfiskuara.	Qeveria MMPH	2016-2017	€1.5 m	80% donator 20% BK
7. Masat e përgjithsme- Edukimi	Zhvillimi i Kurikuleve dhe programeve të edukimit mjedisor lidhur me mbeturit për të gjitha nivelet (kopshtet, shkollat, kolegjet, universitetet)	MMPH MASHT	2014 - 2017	€1.0 m	50% donatorët 50% BK
Kostoja totale				€ 10.45 mln	

3.3. Investimet me kosto të ulët (<€1 milion)

Objektivi 1: Forcimi i sistemit për Menaxhimin e mbeturinave Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturë Objektivi 3: Rritja e e shkallës së vetëdijsimit, ndërgjegjësimit dhe Informimit					
Masat	Qëllimi i investimit -Veprimet	Agjencia udhëheqëse	Periudha kohore	Kostoja e vlerësuar	Burimet e sugjeruara

Mbeturinat					
1. Masat e përgjithsme-Monitorimi	Vendosja e pikave/piezometrave monitoruese për ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë afër deponive të mbeturinave.	MMPH- AKMM	2016-2017	€500, 000	BK
2. Masat e përgjithsme-Menaxhmenti	Hartimi i udhëzuesve për zbatimin e legjislacionit dhe për trajtimin e mbeturinave, ose amandamentimi i akteve ligjore që dalin nga ligji i mbeturinave.	MMPH-DMM	2013 - 2017	€50, 000	BK
3. Masat e përgjithsme-Planifikim	Strategjia /Plani për menaxhimin e mbeturinave	MMPH-DMM	2013	€ 5,000	BK
4. Legjislacioni Masat e përgjithsme	Hartimi i kompletimi i legjislacionit për mbeturina në përputhje me acquis të BE.	MMPH	2013 - 2017	€50,000	BK
5. Masat e përgjithsme-Infrastrukturë	Zgjerimi i hapësirës deponim në deponisë në Sharr;	MMPH Komuna	2015	€250.000	BK
6. Re-ciklimi redukim	Mbështetja e riciklimit të mbeturinave edhe me subvencione	MMPH PSP	2015	€500,000	BK
7. Masat e përgjithsme-Monitorim	Studimi dhe hulumtimi i gjendjes së deponisë Regjionale në Mitrovicë.	MMPH	2015	€400.000	70%Donator 30%BK
8. Masat e përgjithsme-Menaxhimi	Përcaktimi i tarifës dhe rritja e inkasimit për grumbullimin e mbeturinave	Komunat,	2014- 2015	€500, 000	50% donatorë 50% Komunat
9. Masat e përgjithsme- Menaxhim	Rehabilitimi i zonave të ndotura nga mbeturinat, përfshirë trajtimin e mbeturinave të rrezikshme	MMPH Komunat	2013 - 2016	€700, 000	70% donatorë 30% BK
10. Masat e përgjithsme- Informimi	Krijimin e sistemit të informimit për menaxhimin e mbeturinave MMPH- Komuna;	MMPH Komuna	2014- 2015	€200,000	BK
11 Masat e përgjithsme-Monitorimi	Monitorimi dhe kontrollimi i prodhuesve, operatorve dhe eksportuesve të mbeturinave të rrezikshme	MMPH Komunat	2014- 2015	€20, 000	BK
Kostoja totale				€ 3.175 mln	

POLITIKA MJEDISORE DHE PROJEKTET ME NDIKIM NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE					
Objektivi 1: Forcimi i sistemit për Menaxhimin e mbeturinave					
Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturë					
Objektivi 3: Rritja e e shkëlës së vetëdijimit, ndërgjegjësimit dhe Informimit					
Masat	Qëllimi i investimit -Veprimet	Agjencia udhëheqëse	Periudha kohore	Kostoja vlerësuar e	Burimet sugjeruara e
1. Masat e përgjithsme-Menaxhimi	Formimi dhe Zhvillimi i Eko-Fondit	MMPH MeF	2013-2014	€300, 000	80% donatorët 20% BK
2. Masat e përgjithsme-Politika mjedisore	Mbështetje për OJQ-të mjedisore në lidhje me arsimimin jo-formal edhe në fushën e mbeturinave (grupe të caktuara të interesit, edukimi i të rriturve, trajnime).	MMPH	2014 - 2017	€500, 000	80% donatorët 20% BK
3. Masat e përgjithsme Instrumentet ekonomike	Studimi i fizibilitetit për hartimin dhe krijimin e instrumenteve ekonomike edhe lidhur me menaxhimin e mbeturinave.	MMPH MAPL Komunat	2014 - 2017	€500, 000	70% donatorët 30% BK
4. Masat e përgjithsme	Krijimin e programit për menaxhimin e llojeve të caktuara të mbeturinave;	MMPH	2015-2017	€200,000	BK
5. Masat e përgjithsme Planifikim	Strategji për përdorimin e materialit të ricikluar për ndërtim, nga mbeturinat e konstruktimit dhe demolimit	MMPH Komunat	2014-2015	€500, 000	70%donatorët 30%BK
6.Masat e përgjithsme Planifikim	Zhvillimi i programit për trajtimin e vend grumbullimit/deponive të mbeturinave industriale të 'Trepçës	Agjensia Kosovës e Privatizimit -Kompania-Trepça	2015 - 2016	€1.0 mln	20%donatorët 80% AKP Trepça
7. Masat e përgjith Ndërgjegjësimi publik	Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e mjedisit nga mbeturinat	MMPH Komunat MASHT + UP	2014 - 2016	€400, 000	70% donatorët 30% BK
8. Masat e përgjithsme Tranime	Organizimi i trajnimeve për stafin e institucioneve të republikës së Kosovës, lidhur me menaxhimin e mbeturinave	MMPH	2014-2015	€200.000	70% donatorët 30% BK
9.Masat e përgjithsme-Politika mjedisore	Inkurajimi i prodhimit të produkteve ekologjike dhe konsumit të tyre (largimi i qeseve PE, prodhimi dhe përdorimi i materialeve të degradueshme	Qeveria MZHE Prodhuesit MMPH	2014-2017	900.000	30% donator 70%BK
Kostoja totale				€ 4.5 mln	

KOSTOJA TOTALE PROJEKTEVE NË PLANIN 2012-2016 € 45.125 mln